



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.11-115
29.03.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafët 20 dhe 22, dhe në lidhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/ 14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/ 21), në pajtim me nenin 124 paragrafi (1) nënparagrafi 4, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/15 dhe 65/18), Njoftimin me nr.ark.11-1091/2, datë 23.3.2023, Raportin e korigjuar me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark. 11-109/3 datë 23.3.2023, Propozimin PA.1 nr.11-115 datë 27.3.2023, dhe Konkluzionin me nr.ark.02-1364/4, datë 29.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 12-të mbajtur më 28.3.2023 miratoi si vijon:

AKTVENDIM

- 1. Anulohet** në tërësi Aktvendimi për paralajmërim publik dhe përjashtimin e ritransmetimit të shërbimit programor PA1 nr.11-115, datë 14.3.2023.
2. Ky Aktvendim është përfundimtar.
3. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në bazë të Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.11-1091/1 datë 10.3.2023, miratoi Aktvendim për paralajmërim publik dhe përjashtimin e ritransmetimit të shërbimit programor PA1 nr. 11-115 datë 14.3.2023, me të cilën e paralajmëron Operatorin e rrjetit publik të komunikimit elektronik (RRPMM) Shoqërin Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KABEL-NET SHPK Strumicë, për shkeljen e kryer të nenit 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), respektivisht sepse RRPMM SHTR KABEL-NET SHPK Strumicë, për shfrytëzuesit e tij ritransmeton shërbimin programor "Euronews Bulgaria", që nuk përfshihet me certifikatë për regjistrimin e shërbimeve programore të dhëna(lëshuara) nga Agjencia.

Me Aktvendimin për ndërmarrjen e masës - vërejtje publike PA1 nr. 11-115 datë 14.3.2023 të RRPMM SHTR KABEL-NET SHPK Strumicë është urdhëruar menjëherë pas pranimit të aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, respektivisht të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor që nuk është i regjistruar në Agjenci.

Mirëpo, më 23.3.2023, nga ana e Sektorit për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit drejtuar drejtorit të Agjencisë është dorëzuar Njoftim për nevojën e korigjimit të Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore të RRPMM SHTR KABEL-NET SHPK Strumicë me nr.ark.11-1091/2 datë 23.3.2023. Në Njoftim thuhet se: "Pas reagimit të Operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KABEL-NET SHPK Strumicë të dorëzuar në mënyrë elektronike, ndaj së cilës si shtojcë kanë dorëzuar aktvendimin për riemërimin e TV Europës në Euronews Bulgaria. (nr. 11-115, datë 20.3.2023), e dhënë nga rregullatori kompetent - SEM, Njësia për mbrojtjen e të drejtave të autorit ka kryer rishikim shtesë të përmbajtjes së ritransmetuar, gjatë të cilit është konstatuar se ky shërbim programor tashmë ishte i regjistruar në Agjenci, më datë 31.12.2023."

Duke marrë parasysh sa më sipër, Sektori për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit përgatiti Raport me shkrim të korrigjuar për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.11-1091/3 datë 23.3.2023 (Shtojca nr.1 e këtij aktvendimi), ku u konstatuar se gjatë mbikëqyrjes së kryer programore nuk janë konstatuar shkelje.

Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe 22, dhe në lidhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në pajtim me nenin 124 paragrafi (1) nënparagrafi 4 paragrafët 2,3 dhe 4 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, Njoftimi për nevojën e korrigjimit të Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore të RRPMM SHTR KABEL-NET SHPK Strumicë nr.11-1091/2 datë 23.3.2023, Raport me shkrim i korrigjuar mbi mbikëqyrjen e kryer programore nr.11-1091/3, datë 23.3.2023, Propozimin PA.1 nr.11-115, datë 27.3.2023, dhe Konkluzionin me nr.ark.02-1364/4 datë 29.3.2023, Këshilli i Agjencisë miratoi aktvendim me të cilën anulohet dhe shpallet i pavlefshëm në tërësi aktvendimin për paralajmërim publik dhe për përjashtimin të ritransmetimit të shërbimit programor PA1 nr.11-115 datë 14.3.2023.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik mund të ngrejë padi për ngritjetë kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

Raport me shkrim i korrigjuar për mbikëqyrjen e kryer programore nr.11-109/3 datë 23.3.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Dorëzuar tek:

- Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KABEL-NET SHPK Strumicë; dhe
- Drejtuesit të operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KABEL-NET SHPK Strumicë.
- Sektorii për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit;
- Sektorit për çështje Juridike dhe furnizime publike;
- Personi i emëruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për udhëheqjen e Regjistrimit UP 1;